

Takimi i dytë publik për vitin 2017

Standardet e gazetarisë në fokus të takimit të dytë publik të Agjencisë për vitin 2017



Shkup, 29.06.2017 – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele sot realizoi takimin e dytë publik për vitin 2017. Në pjesën hyrëse drejtori i Agjencisë d-r Zoran Trajčevski i prezantoi aktivitetet e realizuara nga Agjencia gjatë tremujorit të kaluar. Krahas mbikëqyrjeve të rregullta që ka realizuar ndaj radiodifuzerëve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik si dhe medimeve të shtypura, Agjencia ka realizuar edhe një numër të madh të mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme të realizuara me detyrë zyrtare në lidhje me disa dispozita ligjore, përfshirë edhe nenin 61 (parimet për realizimin e veprimtarisë) si dhe nenit 48 nga LSHMAA (ndalesë për gjuhë të urrejtjes), me ç'rast një te një televizion është konstatuar shkelje e parimeve për realizimin e veprimtarisë, përderisa te një tjetër për nxitje të diskriminimit në bazë etnike dhe në bazë të grupit të marginalizuar. Gjithsejtë 21 masa të vërejtjes janë shqiptuar për radiodifuzerët, 4 masa vërejtje për operatorët kabllor dhe 2 masa vërejtjesh për publikues të medimeve të shtypura. Është miratuar edhe Vendim për dhënie të lejes për emetim të radios dhe shërbimit programor, radio muzikore-biseduese e formatit të përgjithshëm, në gjuhën maqedonase, në nivel lokal, për rajonin e komunës së Krivogashtanit, si dhe një Vendim për shpalljen e konkursit publik për ndarjen e një leje për institucion joprotitabil të radiodifuzionit për emetim të radios dhe shërbimit programor në nivel lokal, në gjuhën rome dhe maqedonase, për rajonin e komunës së Shtipit. Për nevojat e Agjencisë, është përpiluar një Studim për konstatim të arsyeshmërisë për shpalljen e konkursit publik për dhënie të lejes për radio joprotitabile në nivel lokal, në rajonin e komunës së Shtipit”, si dhe Hulumtim për shtrirjen e radiostacioneve dhe për ndikimin në shikueshmërinë e

përgjithshme të stacioneve televizive që emetojnë program në nivel shtetëror përmes satelitit ose përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik si dhe të stacioneve televizive që emetojnë program në nivel rajonal dhe lokal, për katër muajt e parë të vitit 2017. Në tremujorin e kaluar, Agjencia përpiloi edhe një Analizë të procedurave të iniciuara për kundërvajtje kundër radiodifuzerëve, operatorëve të rrjetit publik të komunikimit elektronik si dhe publikuesve të medimeve të shtypura në periudhën nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2016, ndërsa tani e ca kohë e ka filluar edhe përpilimin e Strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuale për periudhën 2018-2022.



Agjencia gjatë periudhës së kaluar disa herë ashpër ka dënuar disa raste të dhunës ndaj gazetarëve dhe ekipeve mediatike, si dhe kërcënimet e drejtuara ndaj një televizioni rajonal, duke potencuar se çdo formë e dhunës ndaj medimeve është e papranueshme dhe paraqet një sulm direkt ndaj lirisë së të shprehurit. Njëkohësisht Agjencia ka apeluar edhe deri te medimet që të jenë të matur sipas rëndësisë dhe rolit të tyre dhe të marrin përgjegjësitë për të informuar në mënyrë objektive dhe të paanshme, të mos transmetojnë spekulime dhe informata të pakontrolluara, por edhe të mos fshehin fakte, por në mënyrë të saktë të përmbahen ndaj parimeve profesionale për kryerjet të detyrës.

Duke ndjerë nevojën për dialog, i cili do të çojë drejt përmirësimit të gjendjes në gazetari, për shkak rënies së vazhdueshme të respektimit të standardeve të gazetarisë, që e përbëjnë bazën e gazetarisë dhe punës së medimeve, Agjencia këtë takim publik ia ka kushtuar parimeve profesionale të gazetarisë dhe mënyrën e përmirësimit të tyre. Me qëllim që të dëgjohet mendimi i një pjese të bashkësisë lidhur me këtë temë, prezantime kishin edhe Zotan Fidanoski, anëtar i Këshillit të Agjencisë; Ivan Mirçevski, kryetar i asociacionit mediatik të Maqedonisë si dhe drejtor i TV Kanal 5; Marina Tuneva, drejtore ekzekutive e Këshillit për etikë në medime si dhe Dejan Georgjivski, kryetar i Qendrës për zhvillimin e

mediemeve, të cilët i prezantuan pasqyrimet e tyre dhe përvojat lidhur me aspektet aktuale mbi mediumet, përgjegjësia e gazetarëve dhe mënyra se si të arrihen standarde më të larta në gazetari.

Konstatimi i përbashkët që doli nga pjesëmarrësit është se gazetarët kanë rol që të transmetojnë idetë dhe mendimet si dhe të drejtat për të komentuar në mënyrë të ndershme, objektive dhe të saktë, të hulumtojnë dhe ta ruajnë etikën gjatë informimit. Profesionin –gazetar duhet të avancohet vazhdimisht, të investohet në edukimin shtesë të kuadrit të gazetarëve dhe kualitetit në mënyrën e informimit, përmes formimit të të a.sh. “shkolla redaktuese” në kuadër të mediemeve. Mediumet dhe gazetarët duhet të jenë pasqyrë e besimit dhe të mbrojnë interesin publik, të paanshëm, me integritet, pavarësi redaktuese dhe vetë rregullim përmes zbatimit të sanksioneve morale ndaj atyre që nuk i respektojnë standardet profesionale si dhe Kodin e gazetarëve. Të mundësohet një financim stabil i mediemeve, e ata nga ana tjetër të kuptojnë seriozisht rolin që duhet ta kenë në një shoqëri, respektivisht domosdoshmërinë që qytetarëve tu sigurohen të vërteta të ndryshme dhe objektive si dhe pasqyrimet për të gjitha çështjet shoqërore – politike.

– Agjencia e takimit publik të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2017, mund të merret në këtë link

– Fletëparaqitja për pjesëmarrje në takim publik të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2017, mund të merret në këtë link